



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 59

Tiranë – E premte, 26 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 19.4.2019	Për autorizimin e avokaturës së shtetit për kryerjen e procedurave të kontraktimit të shërbimit të konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë “ <i>Tirana International partners</i> ” sh.p.k., për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas, Tiranë, si dhe përcaktimin e procedurës përkatëse të përzgjedhjes..... 4627
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 185, datë 23.4.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 4629
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 186, datë 23.4.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 4632
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 187, datë 23.4.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 4634
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut , datë 5.3.2019	Çështja Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 62907/16</i>) 4637
	Korrigjim gabimi material në vendimin e ERE-s nr. 145, datë 18.9.2017, “Për miratimin e Rregullores mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit, kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 28 shtator 2017..... 4639



VENDIM
Nr. 242, datë 19.4.2019

**PËR AUTORIZIMIN E AVOKATURËS SË
SHTETIT PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË KONTRAKTIMIT
TË SHËRBIMIT TË KONSULENCËS
PËR MARRËVESHJEN E
KONCESIONIT TË LIDHUR ME
SHOQËRINË “TIRANA
INTERNATIONAL PARTNERS” SHPK,
PËR AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
“NËNË TEREZA”, RINAS, TIRANË, SI
DHE PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
PËRKATËSE TË PËRZGJEDHJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c”, të nenit 7, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të neneve 15, pika 8, e 18, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Avokaturës së Shtetit për kryerjen e procedurave të kontraktimit të një zyre avokatie të huaj për shërbimin e konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë “*Tirana International Partners*” sh.p.k., për aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas, Tiranë, si dhe përcaktimin e procedurës përkatëse të përzgjedhjes sipas kushteve e afateve këtij vendimi.

2. Kontraktimi i zyrës së avokatisë së huaj do të realizohet nëpërmjet procedurës konkurruese dhe transparente përzgjedhëse.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit miraton urdhrin për ngritjen e komisionit të kryerjes së procedurës përzgjedhëse të zyrës së avokatisë së huaj për shërbimin e konsulencës për marrëveshjen e koncesionit të lidhur me shoqërinë “*Tirana International Partners*” sh.p.k., për aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas, Tiranë, duke përcaktuar në të:

a) nevojën e kontraktimit bazuar në kërkesat e ardhura nga Ministria e Infrastrukturës dhe

Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

b) kushtet e veçanta që duhet të plotësohen nga zyrat e avokatisë;

c) kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë një zyrë avokatie për t’u bërë pjesë e procedurës konkurruese, si më poshtë vijon:

i. Ekspertiza dhe specializimi i zyrës së avokatisë në fushën e objektit të çështjes për të cilën është vendosur fillimi i procedurës së kontraktimit;

ii. Numri i rasteve të suksesit në raste të ngjashme;

iii. Besueshmëria dhe reputacioni;

ç) objektin e punës/llojin e shërbimeve të kërkuara;

d) përbërjen e komisionit prej të paktën 3 (tre) anëtarësh, një prej të cilëve është kryetari.

dh) detyrat kryesore të komisionit, si më poshtë vijon:

i. Kryetari i komisionit mbledh menjëherë komisionin, pas hyrjes në fuqi të urdhrin të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, dhe vendos për hartimin e dërgimin e ftesës për ofertë disa zyrave të avokatisë të huaja, të renditura të parat në një ose disa nga guidat e renditjes avokatore, si: “*Chambers & Partners*”, “*Legal 500*”, “*Who’s Who Legal*”, si dhe bën njoftimin për ftesë për ofertë në faqen zyrtare të internetit të Avokaturës së Shtetit. Si ftesa për ofertë, ashtu edhe njoftimi në faqen zyrtare, do të jenë në gjuhën shqipe dhe në atë angleze.

ii. Ftesa për ofertë, adresuar zyrave të avokatisë, duhet të përmbajë, të paktën, objektin e kontratës, detyrat e të kontraktuarit, kriteret e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësohen nga ofertuesi, kohëzgjatjen e kontratës, pikëzimin e kriterëve vlerësuese, vendin dhe afatin e dorëzimit të ofertës (datë/orë/vit), si dhe të drejtën e ankimimit.

iii. Njoftimi për ftesë për ofertë në faqen zyrtare të internetit të Avokaturës së Shtetit duhet të përmbajë, të paktën, autoritetin kontraktor dhe adresën e tij, objektin e kontratës, kohëzgjatjen e kontratës, vendin dhe afatin e dorëzimit të ofertës (datë/orë/vit), personin e kontaktit të autoritetit kontraktor dhe mënyrën e komunikimit me të.



iv. Komisioni pret ofertën brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit të ftesës për ofertë.

v. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në nënndarjen “iv”, komisioni merr në dorëzim, hap dhe administron njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit, në një ditë të vetme, ofertat e paraqitura nga zyrat e avokatisë, të specifikuara në to çmimin përkatës për kryerjen e shërbimeve, së bashku me dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor, që vërteton plotësimin e kriterëve të veçanta e të përgjithshme të zyrës, të gjitha këto, të dorëzuara, të mbyllura në zarf.

vi. Pas hapjes së ofertave, komisioni, brenda ditës, analizon ofertat e paraqitura nga zyrat e avokatisë të huaja dhe kontrollon paraqitjen e dokumentacionit përkatës tekniko-ligjor, që vërteton plotësimin e kriterëve të veçanta dhe të përgjithshme të zyrës, me qëllim kualifikimin e tyre, dhe, pas renditjes së zyrave të kualifikuara, përzgjedh zyrën që vlerësohet më tepër.

vii. Pas përfundimit të procedurës përzgjedhëse, komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, zyrat e avokatisë të huaja, që kanë marrë pjesë, zyrën e avokatisë të përzgjedhur, të cilin ia paraqet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, së bashku me klasifikimin përfundimtar të zyrave të avokatisë pjesëmarrëse, sipas pikëve përkatëse.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në bazë të renditjes së dhënë nga komisioni, vendos brenda ditës nga data e paraqitjes së relacionit dhe njofton zyrtarisht zyrën e avokatisë të listuar të parën për vijueshmërinë e procedurave për negocimin e kontratës së shërbimit, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për përzgjedhjen e zyrës së avokatisë.

5. Në rast të tërheqjes nga oferta të zyrës së përzgjedhur brenda 3 (tri) ditëve kalendarike, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit i dërgon njoftim zyrës së avokatisë, e renditur e dyta nga komisioni.

6. Ofertuesit, jo të parët në renditje, mund të ushtrojnë të drejtën e ankimimit lidhur me procedurën e kualifikimit brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e njoftimit të tyre nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit. Ankesat për procedurën e kualifikimit paraqiten, në çdo rast, me shkrim

dhe i drejtohen Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Për shqyrtimin e ankesës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit krijon një komision me jo më pak se 3 (tre) anëtarë të ndryshëm nga komisioni i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, për shqyrtimin e menjëhershëm të ankesës brenda ditës. Po brenda ditës, pas marrjes së raportit të këtij komisioni për shqyrtimin e ankesës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit shprehet lidhur me ankesën dhe njofton menjëherë ankuesin me shkrim.

7. Pas përfundimit të procedurës së ankesave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit negocion dhe nënshkruan kontratën me zyrën e avokatisë të huaj të përzgjedhur sipas procedurës së mësipërme në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për kryerjen e shërbimeve.

8. Pas nënshkrimit të kontratës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave angazhohen në mbështetjen dhe vënien në dispozicion të kontraktorit të të gjithë aksesëve të nevojshme në terrene dhe në dokumentacion mbi bazë të kontratës.

9. Pas nënshkrimit të kontratës dhe hyrjes në fuqi të saj, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit merr masa për të pajisur zyrën e avokatisë të huaj të përzgjedhur me autorizimet përkatëse për kryerjen e shërbimeve.

10. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit cakton, me urdhër, një avokat shteti për ndjekjen e zbatimit të kontratës deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me të kontraktuarin.

11. Kostot financiare (kryerja e pagesës së çmimit të kontratës për të kontraktuarin - zyrën e avokatisë të huaj) do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, bazuar në kushtet specifike që do të përcaktohen në kontratë.

12. Ngarkohen Avokatura e Shtetit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr.185, datë 23.4.2019

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE, QARKU TIRANË, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI I
SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, znj. Albana Sadik Vokshi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin

e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 11 (njëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, janë numri rendor 1 (një) z. Lulzim Xhelal Basha, numri rendor 2 (dy) znj. Orjola Hysni Pampuri, numri rendor 3 (tre) znj. Rudina Azem Hajdari, numri rendor 4 (katër) znj. Grida Agim Shqina (Duma), numri rendor 5 (pesë) znj. Albana Sadik Vokshi, numri rendor 6 (gjashtë) znj. Jorida Hasan Tabaku, numri rendor 7 (shtatë) z. Sali Ram Berisha, numri rendor 8 (tetë) z. Halim Marsut Kosova, numri rendor 9 (nëntë) z. Gent Hysen Strazimiri, numri rendor 10 (dhjetë) z. Fatmir Ali Mediu, dhe numri rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Dashamir Hamit Shehi.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumëmemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance, të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë



nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 22 (njëzet e dy), 23 (njëzet e tre), 24 (njëzet e katër), 36 (tridhjetë e gjashtë), 37 (tridhjetë e shtatë), 39 (tridhjetë e nëntë), 42 (dyzet e dy), 47 (dyzet e shtatë), 49 (dyzet e nëntë), 12 (dymbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 54, 55, 56, 57 datë 12.3.2019, vendimi 70, datë 20.3.2019, si dhe vendimet nr. 101, 103, 104, 105, datë 27.3.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 45, datë 11.3.2019, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit znj. Majlinda Skënder Halilaj, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Lulzim Xhelal Basha.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 13 (trembëdhjetë), 14 (katëmbëdhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë), 20 (njëzet), 21 (njëzet e një).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 115, nr. 116, nr. 120, nr. 121, datë 4.4.2019, dhe vendimin nr. 165, datë 16.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 125 datë 4.4.2019, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Korab Qamil Lita,

për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Orjola Hysni Pampuri.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 25 (njëzet e pesë), 26 (njëzet e gjashtë), 27 (njëzet e shtatë), 28 (njëzet e tetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 157, nr. 158, nr. 159, datë 16.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 181 datë 18.4.2019, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit z. Erion Hysen Piciri, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga znj. Grida Agim Shqina (Duma).

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 29 (njëzet e nëntë), 30 (tridhjetë), 31 (tridhjetë e një), 32 (tridhjetë e dy), 33 (tridhjetë e tre), 34 (tridhjetë e katër) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 32 (tridhjetë e dy), z. Artur Daut Roshi.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2404 prot., datë 17.4.2019, z. Artur Daut Roshi, është njoftuar për dorëzimin e



formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Artur Daut Roshi, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 19.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2136/1, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Artur Daut Roshi, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Subjekti ka deklaruar këto ndryshime në gjenealogjetet e mëparshme:

Emrin e ka ndryshuar nga “Mustafa” në “Artur” dhe ka ndryshuar emri i nënës nga “Zilo” në “Zylke”.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Artur Daut Roshi, rezulton se, në seksionin III “Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit”, në pikën nr. 4 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale”, i është përgjigjur “Po” dhe ka deklaruar se:

- Është ndaluar/arrestuar nga Prokuroria Tiranë, për arsye “Hetim mbi vendosjen e një kandidati për kryetar bashkie Tiranë, pa vullnetin e tij, nën akuzë, parashikuar nga neni 190/3, KP, 24, 26, 27 K.Pr.P, sipas procedimit penal nr. 353, 2007, datë 21.2.2007; vendim nr. 189 akti deri më 22.5.2009; vendim nr. 424, që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr. 819, datë 10.6.2008, deri në mospranim rekursi në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 00-2011-154, datë 18.2.2011; nr. vendimi 30-2009-1447, datë 22.5.2009; me vendim të ndërmjetëm datë 13.3.2007; vendim nr. 69 Regj. Themeltar datë 8.5.2007; vendimi nr. 186/2 datë 5.6.2007, vendim nr. 154. Gjykata e Tiranës, me vendimin nr. 819, datë 10.6.2008, vendosi pushim çështje.

Pyetjes nr. 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? i është përgjigjur “Po, dhe ka deklaruar se:

Ka pasur masë shtrënguese të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale të parashikuar nga neni 190/3, 25, 26, 27 i Kodit Penal.

Vendosja e kandidatit për Bashkinë Tiranë pa vullnetin e tij, plotësimin e formularëve të kandidimit në akuzën e parashikuar nga neni 190/3 KP, 25, 26, 27 K.Pr.P.

Pushimin e çështjes për z. Artur Daut Roshin, akuzuar për veprën penale parashikuar nga neni 190/3-25 K.P, pasi nuk provohet të jetë kryer. Me vendim të Gjykatës Tiranë nr. 819, datë 10.6.2008, i lënë në fuqi me vendim nr. 424, datë 22.5.2009, me rrëzimin e rekursit në Gjykatën e Lartë nr. 00-2011-154, datë 18.2.2011 (nr. vendimi 30-2009-1447, datë 22.5.2009), 21.2.2007, nr. 186 akti 13.03.2007 nr. 67 Akti vendim nr. 819 datë 10.6.2008, Gjykata Tiranë pushoi çështjen.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b”, dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2463 prot., datë 19.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2462 prot., datë 19.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Artur Daut Roshi.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1199/1 prot., datë 19.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Artur Daut Roshi, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Artur Daut Roshi, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të



bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidate të radhës të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 32 (tridhjetë e dy), z. Artur Daut Roshi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, z. Artur Daut Roshi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM Nr. 186, datë 23.4.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU SHKODËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 23.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtar;
Rezarta Bitri: anëtare,
shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Romeo Vilhelm Gurakuqi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Shkodër.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike, për zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet



për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 5 (pesë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Shkodër, janë numri rendor 1 (një) z. Romeo Vilhelm Gurakuqi, numri rendor 2 (dy) znj. Izmira Niazi Ulqinaku, numri rendor 3 (tre) z. Lorenc Karlet Luka, numri rendor 4 (katër) z. Bardh Ali Spahia, numri rendor 5 (pesë) z. Nard Lazer Ndoka.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Shkodër, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore Shkodër, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Shkodër, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 10 (dhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), 6 (gjashtë), 7 (shtatë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 68, 69, 71 datë 20.3.2019, vendimi nr. 100, datë 27.3.2019 si dhe vendimi nr. 122, datë 4.4.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë

Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Shkodër, kanë shteruar.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër 8 (tetë), 09 (nëntë), 11 (njëmbëdhjetë), 12 (dymbëdhjetë), 13 (trembëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 128, datë 9.4.2019, vendimi nr. 160, 161, 164 datë 16.4.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 14 (katërmëdhjetë), 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 156 datë 16.4.2019, ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Zef Gjon Shtjefni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2407 prot., datë 17.4.2019, z. Zef Gjon Shtjefni, është njoftuar për dorëzimin e



formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Zef Gjon Shtjefni, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 18.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2138, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Zef Gjon Shtjefni, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2463 prot., datë 19.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2462 prot., datë 19.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Zef Gjon Shtjefni.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1199/1 prot., datë 19.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Zef Gjon Shtjefni, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Zef Gjon Shtjefni, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015,

“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Zef Gjon Shtjefni.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, z. Zef Gjon Shtjefni.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

VENDIM Nr. 187, datë 23.4.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU SHKODËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 23.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;



Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,
shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, znj. Izmira Niazi Ulqinaku.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Shkodër.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike, për zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 5 (pesë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë

Demokratike, qarku Shkodër, janë numri rendor 1 (një) z. Romeo Vilhelm Gurakuqi, numri rendor 2 (dy) znj. Izmira Niazi Ulqinaku, numri rendor 3 (tre) z. Lorenc Karlet Luka, numri rendor 4 (katër) z. Bardh Ali Spahia, numri rendor 5 (pesë) z. Nard Lazer Ndoka.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Shkodër, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në Zonën Zgjedhore Shkodër, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, Qarku Shkodër, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 10 (dhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), 6 (gjashtë), 7 (shtatë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 68, 69, 71 datë 20.3.2019, vendimi nr. 100, datë 27.3.2019, si dhe vendimi nr. 122, datë 4.4.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Shkodër, kanë shteruar.



Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër 8 (tetë), 9 (nëntë), 11 (njëmbëdhjetë), 12 (dymbëdhjetë), 13 (trembëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 128 datë 9.4.2019, vendimi nr. 160, 161, 164 datë 16.4.2019 ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 14 (katërmëdhjetë), 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 156, datë 16.4.2019, ka vendosur, të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), z. Nikolin Dede Staka.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2409 prot., datë 17.4.2019, z. Nikolin Dede Staka, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit

të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Nikolin Dede Staka, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 18.4.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2139, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Nikolin Dede Staka, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2463 prot., datë 19.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2462 prot., datë 19.4.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Nikolin Dede Staka.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1199/1 prot., datë 19.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet, Qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Nikolin Dede Staka, sipas të cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat Shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Nikolin Dede Staka, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që



zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), z. Nikolin Dede Staka.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, z. Nikolin Dede Staka.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

SEKSIONI I DYTË VENDIM

Kërkesa nr. 62907/16

**Rinaldo Myrtaj dhe të tjerët kundër
Shqipërisë**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur si një Komision, më 5 mars 2019, i përbërë nga:

Valeriu Griçco, *kryetar*,

Ivana Jelić,

Darian Pavli, *gjyqtarë*,

dhe Hasan Bakırcı, *zëvendëssekretar i Seksionit*,

në lidhje me kërkesën e mësipërme, paraqitur më 25 tetor 2016,

në lidhje me deklaratat formale, ku pranohej një zgjidhje me pajtim e çështjes, pasi diskutoi, vendosi si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Një listë me kërkesit paraqitet në shtojcë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjencia e saj e atëhershme, znj. A. Hicka, nga Avokatura e Shtetit.

Kërkesit u ankuan, mbështetur në nenin 2 të Konventës, se e drejta për jetën e familjarëve ishte shkelur si pasojë e veprimeve të Gardës Kombëtare gjatë protestës së zhvilluar më 21 janar 2011. Gjithashtu, ata u ankuan se përdorimi i dhunës vdekjeprurëse nuk ishte absolutisht e nevojshme dhe se autoritetet, nuk kryen një hetim efikas për vdekjen e familjarëve të tyre.

Kërkesa iu komunikua Qeverisë më 20 nëntor 2017.

Më 30 korrik 2018 dhe më 14 dhjetor 2018, Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore, të firmosura nga të gjitha palët.

Deklarata parashtroi si më poshtë:

“Kërkesit ranë dakord të heqin dorë nga pretendime të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet, të cilat ngrenë këtë kërkesë kundër angazhimit të Qeverisë për t’i paguar ata:

Rinaldo Myrtaj, EUR 39,000 (tridhjetë e nëntë mijë euro)

Mamude Myrtaj, EUR 39,000 (tridhjetë e nëntë mijë euro)

Ilmi Deada, EUR 15,600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind euro)

Alma Rredhi, EUR 10,000 (dhjetë mijë euro).

për të mbuluar dëmet monetare dhe jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet, të cilat do të jenë në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës së lartpërmendur prej tre muajsh, Qeveria merr përsipër të paguajë interes të thjeshtë ndaj saj, nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerje, në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës përkatëse plus tre përqind. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Në vijim, Qeveria pranon se hetimi i kryer për rrethanat e vdekjes së të afërmeve të kërkesve nuk pajtohej me nenin 2 të Konventës dhe se këto çështje nuk adresoheshin në procedimet penale të realizuara, të sipërpërmendura.

Gjithashtu, Qeveria ndërmerr rihapjen e procedimeve të brendshme penale për këtë çështje, duke marrë në konsideratë përfshirjen e të afërmeve të viktimave në këto procedime.”



LIGJI

Gjykata përqendrohet në zgjidhjen me pajtim të arritur midis palëve. Ajo sigurohet se zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe në Protokollet e saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës. Për sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime, *Vendos*, ta heq kërkesën nga lista e saj e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 28 mars 2019.


Hasan Bakirci
ZËVENDËSSEKRETAR

Valeriu Griçco
KRYETAR

SHTOJCË

Nr.	Emri/MBIEMRI	Viti i lindjes	Kombësia	Vendbanimi	Përfaqësues
1	Rinaldo MYRTAJ	1986	shqiptare	Fier	D. Matlija
2	Ilmi DEDA	1976	shqiptare	Tiranë	D. Matlija
3	Zabit DEDA ^{*1}	1970	shqiptare	Tiranë	D. Matlija
4	Mamude MYRTAJ	1963	shqiptare	Fier	D. Matlija
5	Alma RREDHI	1975	shqiptare	Fier	D. Matlija
6	Ana VEIZI [*]	1999	shqiptare	Fier	D. Matlija
7	Klasjdi VEIZI [*]	1996	shqiptare	Fier	D. Matlija

¹ Ankesat në lidhje me kërkesit e specifikuar me një asterisk u kundërshtuan si të papranueshme duke qenë se në thelb ishin të njëjtat me ato në kërkesën nr. 16191/13.



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë